

# PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

## INDUSTRITË MINERARE

### ID 3.12 "Impiantet e pasurimit të mineraleve".

*Sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar")*



**SUBJEKTI: "DANMEGER" SHPK**

**NIPT L87118401U**

**VENDNDODHJA: Dibër, Martanesh, LENE, Fabrika e  
Pasurimit të Kromit Danmeger, Zona Kadastrale 2410.**

## 1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti “**DANMEGER**” është i regjistruar ne QKB me Formë Ligjore si **Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar (SHPK)**, i pajisur me Nr. Identifikimi **NIPT L87118401U**, me Administrator **Murat Zguri**.

Fusha e veprimtarisë se operatorit konsiston në Kërkim zbulim, shfrytëzim të pasurive natyrore, nëntokësore dhe mbitokësore, prodhim, shitje, blerje, transportim të kromit dhe pasuri të tjera minerale. Shfrytëzim, zbulim karrierash të ndryshme minerare, Magazinim transpor dhe perdorimin e lendeve plasese e shperthyese dhe inerte malore, lumore.

Aktivitete tregtare ne fushen e importeksport, tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale ushqimore, import-eksport i mallrave. Prodhim aparatesh elektrike, montime industriale, civile dhe mirembajtje impjantesh industriale dhe civile. Aktivitete ne fushen e telekomunikacionit. Sherbime ne fushen e estetikes. Agjenci turistike dhe shitblerje biletash. Bar, restorant, hotel. Tregtimi i artikujve elektroshtepiak, hidrosanitar, materiale ndertimi, tregtim artikujt mobilerie, pjese kembimi per automjete. Transport per vete dhe te tretet, servis makinash , goma automjetesh te ndryshme. Tregti te mjeteve motorike te reja dhe te perdorura. Ruajtja dhe sigurimi fizik I objekteve publike dhe private dhe sigurimin fizik, mbrojtjen e jetes dhe shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj. Licensa te tipit 1.3A. Ndertim te objekteve, transport mallrash te ndryshme etj.

**Subjekti kërkon të aplikojë për leje mjedisi Tip B për aktivitetin:**

### INDUSTRIË MINERARE ID 3.12 “Impiantet e pasurimit të mineraleve”.

*Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.*

## 2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

1. Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikoje ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:
  - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
  - Ndikimi ne flore/faune;
  - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
  - Ndikime social-ekonomike;
  - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
  - Ndikim ne peizazhin e zones;
2. Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.


**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**NIPT L87118401U**

**3. VENDODHJA E AKTIVITETIT**

Vendi ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti qe do te kryejë subjekti ndodhet në vendndodhjen: **Dibër, Martanesh, LENE, Fabrika e Pasurimit të Kromit Danmeger, Zona Kadastrale 2410.**

Koordinatat e objektit janë si më poshtë:

PLANVENDOSJE E SIPERFAQEVE TE KERKUARA PER PERDORIM NE ORTOFOTO DHE PARCELAT KADASTRALE  
(Per ushtrim te veprimtarise se perpunimit te mineralit nga Subjektit "DANMEGER Sh.p.k")



**LEGJEDE**

	Parcela 1 Sip=0.32Ha		Parcela 3 Sip=0.4Ha
	Parcela 2 Sip=1Ha		Siperfaqe ku eshte ndertuar fabrika

Fshati Lene,Zona kadastrale Nr.2410, Njesia Administrative Martanesh, Bashkia Bulqize



Sistemi Koordinativ Shteteror,Kuota absolute  
Projeksioni Gauss kryqer

Emertimi:	Planvendosje Danmeger Sh.p.k
Parosites:	DANMEGER Sh.p.k
Punoi:	Kujtim Kpeli
Ligjence:	T.0552/1
Shkalla:	1:2000

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**NIPT L87118401U**

<b>KOORDINATA FABRIKA</b>		
<b>Nr</b>	<b>Y</b>	<b>X</b>
<b>1</b>	4439351.181	4586346.059
<b>2</b>	4439368.951	4586308.644
<b>3</b>	4439372.722	4586301.376
<b>4</b>	4439405.734	4586318.912
<b>5</b>	4439402.781	4586325.601
<b>6</b>	4439391.052	4586349.044
<b>7</b>	4439388.588	4586353.058
<b>8</b>	4439357.331	4586350.087

<b>KOORDINANTAT SHESHI I DEPOZITIMIT KROMI VARFER</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Y</b>	<b>X</b>
<b>1</b>	4439338.688	4586350.338
<b>2</b>	4439335.667	4586367.013
<b>3</b>	4439342.277	4586375.644
<b>4</b>	4439348.755	4586410.167
<b>5</b>	4439424.305	4586383.689
<b>6</b>	4439422.629	4586362.217


<b>KOORDINATAT PESHORJA</b>		
<b>Nr</b>	<b>Y</b>	<b>X</b>
<b>1</b>	4439460.626	4586348.88
<b>2</b>	4439443.462	4586349.665
<b>3</b>	4439443.953	4586339.860
<b>4</b>	4439456.561	4586341.292

<b>KOORDINATAT DAMPA 1</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Y</b>	<b>X</b>
<b>1</b>	4439312.836	4586282.459
<b>2</b>	4439332.012	4586216.066
<b>3</b>	4439403.437	4586242.884
<b>4</b>	4439443.021	4586269.702
<b>5</b>	4439442.167	4586314.425
<b>6</b>	4439445.380	4586320.423

<b>KOORDINATA DAMPA 2</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Y</b>	<b>X</b>
<b>1</b>	4439213.241	4586128.75
<b>2</b>	4439254.438	4586099.805
<b>3</b>	4439221.61	4586094.592
<b>4</b>	4439241.455	4586061.076
<b>5</b>	4439325.884	4586027.855
<b>6</b>	4439341.142	4586034.715
<b>7</b>	4439338.505	4586064.664
<b>8</b>	4439326.794	4586097.319
<b>9</b>	4439283.156	4586121.721

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**NIPT L87118401U**

**PLANVENDOSJE E SIPERFAQEVE PERBERESE TE FABRIKES MBI ORTOFOTO DHE PARCELAT KADASTRALE**  
(Per ushtrim te veprimtarise se perpunimit te mineralit nga Subjekti "DANMEGER Sh.p.k")



**LEGJEDE**

- |   |   |   |   |
|---|---|---|---|
|  | Parcela me Sip=1Ha(Marre me qera nga bashkia "Bulqize")     |    | Sheshi i depozitimit te mineralit te varfer |
|  | Parcela me Sip=0.72Ha(Marre me qera nga bashkia "Bulqize" ) |    | Peshore                                     |
|  | Fabrika   |    | Dampa 1                                     |
|   |   |  | Dampa 2                                     |

Objekti i Përpunimit të Mineralit "DANMEGER" në Thekën do të ngrihet në një shesh ndërtimi që ndodhet në një distance rreth 2 kilometra nga ish Sektori i Minierës së Kromit Thekën në krahun e majtë të rrugës automobilistike lokale Ballej – Thekën që shkon në drejtim të minierës. Do të shfrytëzohet për këtë qëllim rënia natyrale e terrenit për të bërë të mundur lëvizjen gravimetrike të mineralit në maksimumin e mundshëm për të eliminuar sa më shumë numurin e makinerive në përdorim si dhe reduktimin e energjisë elektrike. Vendi i zgjedhur për ndërtimin e Objektivit i plotëson të gjitha kushtet gjeologjike, hidro gjeologjike dhe sizmike për ndërtimin e një objekti të tillë.

Zona në studim është pjesë e Fshatit Lene, Martanesh. Vete fshati Lene me reformen e re territoriale është pjesë e Bashkisë Bulqize. Është në përgjithësi një zonë malore me lumenj dhe përrenj që e përshkruajnë të gjithë zonën. Territori i këtij fshati përbëhet pothuajse tërësisht nga male të larta dhe kodra, ndërsa zona ku do të ndërtohet fabrika është pothuajse e pabanuar dhe aktiviteti kryesor i zonës rreth e qark është bujqësia dhe blegtoaria. Gjithashtu banorët e kësaj zone merren edhe me shfrytëzimin e minierave të kromit.

## **ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE (ELEMENTËT EKZISTUES TË TERRITORIT)**

### **Informacion për topografinë e zonës**

Sheshit i cili do të nënshtrohet punimeve të ndërtimit dhe sistemit ndodhet në një terren me pjerrësi rreth 20°, me drejtim veriperendim - juglindje.

Parcela e vendosur në këtë terren të pjerrët, është e lire dhe ka vetëm një ndërtim ekzistues në afërsi që mund të funksionojnë së bashku me ato që propozohen. Ky ndërtim është pronësi e investitoreve dhe do të përdoret si Zyra, Oficinë dhe Laborator.

Zgjedhja e kësaj parcele është bërë për këto arsye kryesore: së pari ndodhet në afërsi të burimeve minerare dhe së dyti pjerrësia e terrenit ndihmon në lëvizjen gravimetrike të materialeve gjatë procesit teknologjik dhe së treti është në pronësi të investitoreve të këtij objekti.

### **Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zonë të tilla)**

Duke qënë se zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, nuk ka parashikime të tilla, që mund t'i referojmë në këtë dokument.

### **Informacion mbi zonat e mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore edhe historike**

Zona ku do të zhvillohet ndërtimi është një zonë e zhveshur, por në afërsi të saj ka pasur dhe ka miniera për nxjerrjen e mineralit të kromit. Zona për zhvillim nuk ka objekte me status "monument kulture", "zonë historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur".

### **Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj**

Infrastruktura rrugore është shumë e dëmtuar. Aktualisht infrastruktura ekzistuese është e mangët. Ajo do të ndërtohet në funksion të strukturave të propozuara. Infrastruktura ekzistuese rrugore shtrihet deri në parcelën që do të zhvillohet, duke e bërë të aksesueshme dhe duke krijuar lehtësira në zhvillimin e godinave të propozuara. Qarkullimi për në parcelë do të bëhet sipas pozicionit që diktojnë vetë godinat, duke ndjekur sistemin e brendshëm rrugor i cili do të pajiset me rrugë të reja.

Përgjithësisht zona nuk ka mungesa të burimeve të ujit, kryesisht si zonë që shtrihet në anë të përroit të Theknës, i cili është një përrua që ka ujë të mjaftueshëm edhe në muajt më të thatë të vitit. Furnizimi me ujë i fabrikës do të bëhet nga vetë shoqëria "Danmeger" sh.p.k me anë të Stacionit të linjës së të ujit që do të ndërtohet pranë përroit të Theknës.

Shkarkimi i ujrave të zeza do të bëhet në "gropa septike". Një pjesë e mirë e rrjedhjeve shkon në nivelet baze të tokave dhe ujërave. Mbetjet do të mblidhen nga shërbimet private të angazhuar për këto aktivitete.

Furnizimi me energji elektrike është lehtësisht i zgjidhshëm. Në afërsi të zonës ku do të ndërtohet fabrika kalon linja e tensionit të mesëm 10 Kv Krastë – Minierat Thekën prej nga do të bëhet edhe furnizimi me energji elektrike i fabrikës me një linjë ajrore. Kjo linjë e tensionit të lartë do të ndërtohet nga vetë shoqëria "Danmeger" sh.p.k.

#### **Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistues**

- Zonë malore pa ndërtime industriale
- Përdorimi aktual trull me ndërtesa përkatese me karakter industrial
- Infrastruktura e zonës nuk ekziston, por do të krijohet, me sistem rrugor të aksesueshem, por me rrjet të brendshëm rrugor që do të krijohet si dhe me linjë elektrike që gjithashtu do të ndërtohet e re

#### **Pamja e jashtme e godinave/ Trajtimi i fasadave/ Trajtimi i mbulesave**

Strukturat që do të zhvillohen në këtë zonë do të respektojnë ambjentin rrethues. Ndërtimi fillestar do të bëhet i zbuluar, do të ndërtohen vetëm bazamentet e makinerive dhe në një fazë të dytë mund të bëhet edhe mbulimi i tyre me konstrukcion të lehta metalike dhe çati gjithashtu me konstrukcion e kapriatë metalike. Objektet që do të ndërtohen do të ndikojnë në pejsazhin e zonës, por në mënyrën që do të zhvillohen jo vetëm që nuk do ta dëmtojnë këtë pejsazh, por do të përmirsojnë duke krijuar një imazh industrial.

Arkitektura është e thjeshtë dhe respekton linjat e pastra gjeometrike dhe kuadratike në strukturat e zhvilluara. Duke qenë një objekt industrial qëllimi kryesor është funksionimi normal i teknologjisë dhe puna pa ndërprerje e objektit, duke respektuar edhe një harmonizim të reparteve, normat për hyrje-daljet dhe qarkullimin e njerëzve, automjeteve edhe mallrave, ngjyrat që duhet të përdoren, materialet që duhet të përdoren, lartësitë e ambjenteve etj. Nga projektimi mbi bazat e normativave për këto tipe ndërtimesh, përftojmë volume të ndryshme, të cilat rrinë në harmoni me njëra-tjetrën dhe lidhen me struktura metalike karakteristike për këtë lloj arkitekture.

#### 4. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

##### FURNIZIMI I OBJEKTIT ME MINERAL

Objekti i Përpunimit të Mineralit "DANMEGER", Thekën do të furnizohet me mineral të varfër nga vendburimi Thekën si dhe nga vendburime të tjera në afërsi të saj. Kapaciteti përpunues i Objektivit do të jetë 10 ton/orë dhe në varësi të orëve dhe ditëve të punës në vit, kapaciteti përpunues do të jetë rreth 70.000 - 75.000 ton ose 6.000 ton/muaj. Vendodhja e Objektivit parashikohet që të bëhet në lartësinë 1060 m mbi nivelin e detit dhe duke marrë në konsideratë dimrin e ashpër të kësaj zone mendojmë të llogarisim 9 muaj punë të Objektivit dhe në këtë mënyrë do të kemi rreth 54.000 ton mineral përpunim në vit, në fazën e parë të ndërtimit, pasi në një fazë të dytë ne parashikojmë ta mbulojmë dhe mbyllim objektin kështu që do të shkojmë në vlerat e para të përpunimit. Përmbajtja e Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> në mineralin fillestar do të jetë 20% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> me minimum deri në 10% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>. Mund të përpunohen në këtë Objekt edhe minerale me përmbajtje deri në 10% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, por në këto raste do të kishim ulje të treguesave, si të rikuperimit ashtu edhe të atyre ekonomikë.

##### TREGUESIT TEKNOLOGJIKE TE PERPUNIMIT

Siç u tha dhe më lart, për efekt të llogaritjes së treguesve teknologjikë të përpunimit është pranuar që cilësia e mineralit të jetë 20% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>. Pra treguesit teknologjik të mëposhtëm do të sigurohen për cilësi minerali me 20% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, pavarësisht se Objekti do të mund të pranojë për përpunim dhe minerale me përmbajtje Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> edhe më të ulët, por sipas kushteve specifike të tregut mund të përpunojë edhe minerale me përmbajtje më të lartë se 20% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>. Treguesit teknologjikë të pasurimit të përgjithshme dhe të pjesëshme sipas hallkave të procesit së bashku me listën e makinërive të perzgjedhura janë paraqitur në skemën teknologjike të lidhjes së aparateve, që është pjesë përbërëse e këtij relacioni, por në mënyrë të përmbledhur paraqiten dhe në tabelën e mëposhtme:

Emertimi i produktit	Dalja në %	Përmbajtja e Cr <sub>2</sub> O <sub>3</sub> në %	Rikuperimi në %
Koncentrat	29	49	70
Sterile	71	8	30
<b>Mineral fillestar</b>	<b>100</b>	<b>20</b>	<b>100</b>



## PERSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK

Objekti i Përpunimit të Mineralit Thekën do të përdorë metodën gravimetrike të pasurimit ashtu siç përdoret në të gjitha Objektet e pasurimit të kromit në vendin tonë, të ndërtuara deri tani. Kjo lloj teknologjie përdoret jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vendet e tjera në botë që pasurojnë minerale të varfëra të kromit, si Turqia, Afrika e Jugut, etj.

Proçesi teknologjik në Objektin e Përpunimit të Mineralit DANMEGER kalon në katër etapa kryesore, që përbëjnë dhe repartet kryesore të ketij Objekti dhe që janë:

1. Proçesi i thyerjes
2. Proçesi i bluarjes
3. Proçesi i pasurimit
4. Proçesi i çujzimit të produkteve

1. **Proçesi i thyerjes** – Shërben për zvoglimin e madhësisë së coprave të mineralit nga maksimum 300 mm deri në 30 mm. Objekti i Përpunimit të Mineralit do të furnizohet me mineral nga vendburimet në afersi të saj. Minerali do të transportohet nga vendburimet në sheshin e depozitimit të objektit me automjete vetëshkarkuese. Kapaciteti depozitues i sheshit do të jetë rreth 2500 ton dhe siguron punë të pandërprerë të Objektit për rreth 10 dite, duke bërë të mundur funksionimin normal të tij (përrjashtuar ata muaj që Objekti nuk do të punojë) kur mund të ndërpritet furnizimi për arsye meteorologjike. Proçesi i thyerjes do të realizohet me dy shkallë thyerje me cikël të hapur. Minerali i grumbulluar në sheshin përkatës të depozitimit të Objektit, nëpërmjet bunkerit dhe ushqyesit lëkundës Nr.101 kalon në thyesin me nofulla Nr.102, ku realizohet thyerja e parë. Nga thyesi i parë me vetë-renie materiali kalon në thyesin e dytë Nr.103 ku behet thyerja e mëtejshme e tij gjër në madhësinë e kokrrizave nën 30 mm. Materiali i thyer nën 30 mm kalon po me vetërrjedhje në mullirin e bluarjes së parë.

2. **Proçesi i bluarjes** – Shërben për zvoglimin e mëtejshëm të madhësisë së kokrrizave të mineralit nga 30 m/m në minimum 0.4 mm nëpërmjet procesit të bluarjes. Proçesi i bluarjes realizohet me dy shkallë bluarje. Proçesi i bluarjes së parë do të jetë në cikël të hapur. Në këtë fazë procesi i bluarjes realizohet i kombinuar me procesin e pasurimit për të shfrytëzuar pasurimin e kokrrizave të zberthyera (pjesërisht) të mineralit të dobishëm nga pjesa sterile. Kokrrizat nën 30 mm kalojnë në procesin e bluarjes në Mullirin Nr.104. Materiali i bluar kalon në një Sitë Baraban Nr.105 me vrimë 1.1 mm. Materiali nën 1.1 mm kalon me anën e Pompave të Reres Nr.108 dhe 109 në hidrociklonet me diametër 250 mm Nr.112 nga ku largohet pjesa shllamore (pjesa shumë e imët e mineralit të bluar), kurse pjesa tjetër kalon në procesin e pasurimit në tri bateri spiralesh me dy shkallë pasurimi me Nr.113 dhe 114, ku fillimisht në shkallën e parë përftohet koncentrat me përmbajtje të lartë  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  (rreth 48%) dhe

gjysëmprodukt me përmbajtje të ulet  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  (rreth 12%), ndërsa në shkallën e dytë përftohen tre produkte: Koncentrat kromi (me rreth 48%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ), steril (me rreth 5%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) dhe gjysëmprodukt (me rreth 20%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ). Materiali me madhësi më të madhe se 1.1 mm i përftuar nga sitisja në sitën Nr. 105 kalon për bluarje të mëtejshme në mullirin Nr. 106 të bluarjes së dytë.

3. **Proçesi i pasurimit** – Ky proces është vazhdimi i procesit të pasurimit të kryer me anë të spiraleve pasuruese dhe shërben për pasurimin e mëtejshëm të mineralit të bluar. Këtu materiali transportohet fillimisht me vetërrjedhje në shpërndarësin e pulpës ku realizohet ndarja e mineralit në tavolinat e pasurimit, që janë të gatshme për pasurim. Kapërderdhja e klasifikatorit spiral Nr. 107 (do të përmendet më poshtë) së bashku me kapërderdhjen e hidrociklonit Nr.112 para baterise së spiraleve pasuruese do të kalojnë me anë të pompes së shllameve Nr. 110 në një Bateri Hidrociklonësh Nr.115 me diametra 75 për të larguar si steril pjesë shumë të imta të mineralit, të pamundura për t'u pasuruar. Në pompen e shllamet Nr. 110 do të shkoje sic e përmendëm më lart edhe kapërderdhja e klasifikatorit spiral Nr. 113. Në klasifikatorin spiral Nr.113 do të kalojnë të gjitha fraksionët e trasha të rërës (jo shllame) prej nga ku do të përfitohen fraksionet e imta (shllamet) të cilat do të rifuten në proces, ndersa pjesa e trashë (rëra) do të shkoje për në Dampë. Nga shpërndarësi i pulpës materiali kalon në tavolinat një katëshe të koncentrimit përkatëse të shkallës së parë Nr 111, prej ku përftohet koncentrat kromi (me rreth 51%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ), steril (me rreth 4%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) dhe gjysëmprodukt (me rreth 15%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ). Gjysëmprodukti kalon për pasurim të mëtejshëm në tavolinat një katëshe të koncentrimit të shkallës së dytë po Nr.111, prej ku përsëri përftohet koncentrat kromi (me rreth 46%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ), steril (me rreth 3.5%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) dhe gjysëmprodukt (i pallogaritur në sasi dhe cilësi), për të cilin parashikohen dy mundësi: ose të kalojë përsëri për pasurim në shkallën e parë të pasurimit me tavolina koncentrimi (pasurimi me cikël të mbyllur) nëpërmjet një pompe rere (optional), ose do të kalohet në steril. Materiali i trashë i Baterisë së Hidrociklonëve Nr.115 do të kalojë në proçes pasurimi fillimisht në tavolina një katëshe pasurimi Nr.111 (këto tavolina kanë disa ndryshime të vogla në konstruksionin e tyre dhe quhen Tavolina Shllamesh), prej ku përftohen koncentrat (me rreth 43%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ), steril (me rreth 12%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) dhe gjysëmprodukt (me rreth 16%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) Ky gjysëmprodukt do të kalojë për pasurim të mëtejshëm në tavolinë koncentrimi një katëshe Nr.111, prej ku do të përftohen koncentrat (me rreth 40%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ), sterile (me rreth 12.5%  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) dhe gjysëmprodukt (i pallogaritur në sasi dhe cilësi).
4. **Proçesi i çujezimit** – Është proçesi më i rëndësishëm ndihmës dhe që shërben për çujëzimin e koncentratit dhe të sterileve, proces që bën të mundur jo vetëm transportimin e koncentratit të kromit për në destinacion, por bën të mundur edhe rikuperimin dhe riqarkullimin e ujit të përdorur në proces.

### **a.Çujezimi i Koncentratit**

Çujezimi i koncentratit do të bëhet së pari në Vaskën e Koncentratit të projektuar dhe ndërtuar për këtë qëllim. Në këtë vaskë do të kalojë e gjithë sasia e koncentratit që prodhohet në spiralet dhe në tavolinat e koncentrimit dhe në çdo 3 deri 4 ditë do të spostohet në sheshin e depozitimit ku do të behet edhe çujezimi përfundimtar i saj. Sheshi i depozitimit do të ketë 1% pjerrësi nga qendra në drejtim të anëve për të bërë të mundur largimin e ujit nga koncentratit.

### **b.Çujezimi i sterileve**

Problemi më i madh me të cilin përballen sot të gjitha Objektet e perpunimit, jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë botën është jo çujezimi i sterileve, por depozitimi i tyre. Këto janë procese të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe zgjidhja është e përbashkët. Depozitimi i sterileve do të behet në atë që quhet DAMPE dhe që vendoset në pjesën më të poshtëme të Objekti i Përpunimit të Mineralit duke bërë të mundur transportin e sterileve dhe të ujit me vetërrjedhje. Dampa fillestare krijohet me material nga vendi duke krijuar një digë me lartësi 5 metra dhe me mbushjen e saj me sterile (shllam dhe rërë) bëhet ngritja e saj me vetë materialin e mbledhur gjatë kohës. Cilësia e ujit që largohet nga Objekti i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në ligjet për mbrojtjen e mjedisit. Duhet me theksuar se në proces nuk përdoret asnjë lloj kimikati dhe i gjithë procesi zhvillohet në prani të ujit. Gjithashtu edhe gjatë procesit nuk krijohet asnjë lëndë apo produkt i dëmshëm për mjedisin.

## **FURNIZIMI ME UJE**

Nevojat e Objekti i Përpunimit të Mineralit për ujë teknologjik janë 20 l/sek. Kryesisht uji do të sigurohet me vetërrjedhje nga përroji që ndodhet në afërsi të Objektit të ardhshëm në pjesën perballë sheshit të parashikuar për ndërtim në një distancë rreth 900 m dhe në një disnivel prej 50 m nga reparti i pasurimit i cili është dhe konsumatori kryesor i ujit teknologjik. Në Objektin që parashikohet të ndërtohet mendohet që të instalohen edhe pompa për riqarullimin e ujit në një stacion pompimi në të ardhmen nëse sasia e ujit do të rezultojë e pamjaftueshme. Ky stacion pompimi është edhe stacioni kryesor i furnizimit të Objektit me ujë teknologjik. Sasia prej 20 l/sek që duhet për punë normale të Objektit do të sigurohet kryesisht nga riqarkullimi i ujit prej dampes në sasinë 15 l/sek, ndërsa sasia tjetër prej 5 l/sek do të jetë sasia që do të sigurohet nga burimet e zonës. Në pjesën e sipërme të Objektit do të ndërtohet edhe një rezervuar për mbajtjen e ujit me kapacitet rreth 10 m<sup>3</sup>, që mund të sigurojë punë pa ndërprerje të Objektit për rreth 1/2 orë. Ndërtimi i stacionit të pompimit është optional. Së pari do të punohet me ujrat e lire (që nuk përdoren) të zonës dhe në rast mosfurnizimi të Objektit me ujë të kalohet në ndërtimin e stacionit të pompimit për riqarkullimin e ujit.

Furnizimi me ujë të pijshëm do të bëhet nga një burim në afërsi të vendit ku do të ndërtohet Objekti me një linjë të vecantë.

### Kanalizimet

Te gjitha ujrat teknologjike të tepërta që dalin gjatë realizimit të proceseve teknologjike, sic u tha më lart, në pjesën e cupezimit të produkteve, do të largohen me anë të kanaleve në përrojin që ndodhet poshtë zonës ku do të ndertohej Objekti. Duhet me theksuar se të gjitha ujrat që do të dalin nga procesi do të jenë në përputhje me të gjitha normat e vendosura për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu në proces nuk përdoret asnjë lende kimike dhe gjatë procesit nuk krijohet asnjë lende e rrezikeshme për mjedisin. Sic u shprehëm edhe më lart në këtë projekt në mundësojmë riciklimin e ujit në proces me anë të dekantimit për të bërë të mundur uljen sasirave të ujit të fresket që përdoret në këtë Objekt.

Ndërsa ujrat e bardha higjieno-sanitare sistemohen po ashtu në kanalet ujembledhës të zonës.

Ujrat e zeza do të sistemohen me gropa septike.

## **FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE**

### Furnizimi me energji për fuqinë motorike

Furnizimi me energji elektrike i objektit për nevojat e fuqisë motorike dhe të ndricimit do të bëhet përmes linjës ajrore të tensionit të lartë që do të vijë nga linja e tensionit të lartë që furnizon minierat e Theknës. Projekti elektrik si i Objektit ashtu edhe i Linjës Elektrike të Tensionit të mesëm janë hartuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe standarteve që përdoren në Shqipëri-KTP STASH, si dhe në respektim të normave europiane EN dhe rekomandimeve CEI për impiantet elektrike dhe punimet instalatore elektrike. Fuqia e instaluar në këtë Objekt është 300 kw. Linja ajrore do të furnizojë transformatorin 400 kVA i cili bën reduktimin e tensionit nga 10 kV në 04 kV. Nga kabina elektrike e ndodhur në brendësi të objektit me anë të kabllave bëhet furnizimi me energji elektrike i panelit të fuqisë dhe komandimit të linjës së pasurimit të kromit. Në kabinën e tensionit të lartë do të vendosen edhe matësit e konsumit të energjisë elektrike. Objekti i Përpunimit të Mineralit DANMEGER parashikohet që të ketë komandim manual të pajisjeve të instaluar në të, por do të ketë mundësi edhe për komandim automatik të saj. Nuk parashikohet që të ketë linjë sekondare të furnizimit të objektit me energji elektrike.

### Ndricimi.

#### **Ndricimi i brendeshëm**

Në projekt, nëpërmjet panelit elektrik të shpërndarjes së tensionit të ulët, është parashikuar ndricimi i të gjitha mjediseve teknologjike dhe laboratorike të punës.

### **Ndricimi i jashtem**

Rregjimi me dy ndërresa ose tri ndërresa ka diktuar edhe ndricimin e plotë të jashtëm e sidomos zonat e realizimit të proceseve teknologjike. Eshtë siguruar gjithashtu edhe ndricimi i mjedisit për rreth, duke përfshirë edhe rruget e hyrjes dhe të daljes.

### **Nderlidhja**

Nderlidhja e objektit realizohet me telefona celulare të siguruar nga sipërmarresi.

#### **4.1. Menaxhimi I instalimit**

### **ORGANIZIMI I PUNËS DHE FUQIA PUNTORE**

#### **Regjimi i punës:**

Kapaciteti maksimal përpunues i Objektit do të jetë 70.000 ton/vit ose 10 ton/orë. Objekti i Përpunimit të Mineralit është projektuar që të mund të punojë 300 ditë në vit me mesatarisht 24 orë në ditë. Do të punohet me tre ndërtesa 8 orëshe në ditë. Në muajt e dimrit me temperature tepër të ulta është parashikuar të mos punojë.

#### **Fuqia puntore:**

Objekti i Përpunimit të Mineralit do të ketë gjithsejt 29 punonjës, të ndarë në reparteve sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i repartit</b>	<b>Numri i puntoreve</b>
1	Sheshi i depozitimit dhe thyerja	6
2	Reparti i bluarjes	9
3	Reparti i pasurimit	6
4	Reparti i çujëzimit	3
5	Reparti i mirëmbajtjes	2
6	Reparti i peshimit dhe laboratorit kimik	2
7	Administrata	1
<b>Gjithsej</b>		<b>29</b>

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**NIPT L87118401U**

**Tabela e meposhteme jep informacion mbi kushtet e punes.**

<b>KUSHTET E PUNËS</b>						
Numri total i punonjësve	<b>29</b>					
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA	
	<b>1</b>	-	<b>2</b>	-	Sheshdepozitim & thyerja	<b>6</b>
					Reparti i bluarjes	<b>9</b>
					Reparti i pasurimit	<b>6</b>
					Reparti i çujëzimit	<b>3</b>
					Reparti i peshimit dhe laboratorit kimik	<b>2</b>
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat/Administrata		Instalimet			
	<b>08<sup>00</sup>-16<sup>00</sup></b>		<b>08<sup>00</sup>-16<sup>00</sup></b>			
Orët e punës	Zyrat/Administrata		Instalimet			
	<b>8 orë/ditë</b>		<b>8 orë/ditë</b>			
Numri i ditëve të punës në vit	<b>312 ditë/vit</b>					
Numri i orëve në vit	<b>312 ditë x 8 orë = 2496 orë/vit</b>					
Variacionet sezonale	<b>Nuk preket nga variacionet sezonale</b>					
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variacioneve sezonale		Pjesa tjetër e vitit			
	<b>Nuk ka</b>		<b>1 turn → 08<sup>00</sup>-16<sup>00</sup></b>			
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet		<b>Dita e dielë është pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 24 ditë/pune pushimi në vit.</b>			
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		<b>Nuk ka</b>			

**4.2. Lëndët e para dhe ndihmëse**

Lëndë të para	Lëndë/ materiale ndihmëse
Krom	Ujë
-	Karburant
-	Energji elektrike

## 5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise, e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete ndikime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

<b>RREZATIMI JONIZUES</b>
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese, pasi vetë natyra e aktivitetit nuk shoqerohet me ndikime të tilla.
<b>VIBRACIONE</b>
Përsa i takon problemeve të vibrimeve që lidhen me punën e makinerive të rënda, ato do të jenë përsëri brenda normave, por janë tepër minimale dhe nuk merren në konsiderate. Për të reduktuar në maksimum nivelin e zhurmave, makineritë që shërbejnë për bluarjen e mineralit, mullinjët do të përdoren me veshje gome.
<b>NDIKIMET NË AJËR</b>
Ushtrimi i ketij aktiviteti nuk do të ketë ndikim në cilësinë e ajrit të zonës pasi sasia e pluhurave që mund të clirohen gjatë shfrytëzimit do të jenë jo vetëm brenda normave të miratuara për këtë qëllim, por mjaft minimale. Sidoqoftë subjekti ka marre edhe masa suplementare në këtë aspekt dhe nga më kryesoret është përdorimi i sprucimit të ujit gjatë procesit të thyerjes. Gjithë proceset e tjera zhvillohen në të lagët, kështu që nuk ka asnjë mundësi për krijimin e pluhurave shtesë. Gjatë punës së kësaj fabrike nuk ka emetim të asnjë lloj gazi. Duhet me theksuar gjithashtu se në këtë fabrikë nuk përdoret asnjë lloj kimikati ose substancë e dëmshme për mjedisin.
<b>NDIKIMET NË POPULLËSI</b>
Realizimi i aktivitetit nuk do të ketë ndikime në levizjen apo zhvendosjen e popullësisë së rajonit ku do zhvillohet aktiviteti. Gjatë funksionimit të aktivitetit nuk ka emetime në ajër, tokë apo ujë, të cilat ndotin ambjentin dhe të rrezikojnë shëndetin e punonjësve apo të popullësisë së rajonit, kjo pasi aktiviteti ka një largësi të konsiderueshme nga zonat urbane dhe është jashtë vijës së verdhë urbane.
<b>NDIKIMET NË TOKË</b>
Sipërfaqja në të cilën do të zhvillohet veprimtaria është një sipërfaqe e zhveshur toke, e cila duke pasur parasysh perbërjen e saj nuk mund të përdoret për tokë bujqësore, gjithashtu ushtrimi i aktivitetit në këtë zonë nuk ndikon negativisht në sasinë dhe cilësinë e tokës.
<b>NDIKIMET NË UJËRA</b>
Ky aktivitet nuk përdor ujin gjatë proceseve të punës. Nuk ka shkarkime të ujërave teknologjike në mjedisin përreth. Mund të përmendim vetëm ujërat higjeno-sanitare të ambienteve të tualeteve dhe të larjes e pastrimit të ambienteve të punës. Këto ujëra shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zonës.

#### NDIKIMET NË KLIMË

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon aspak në kushtet klimaterike të kësaj zone.

#### NDIKIMET MBI FLORËN DHE FAUNËN

Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë jo e banuar, në afërsi të minierave ekzistuese dhe me përmasa jo të mëdha që të mund të ndikojë në florën dhe faunën e zonës.

#### MBETJET

**Mbetje jo të rrezikshme urbane** - Këto mbetje do të gjenerohen nga punonjësit e punësuar në këtë aktivitet. Për menaxhimin e këtyre mbetjeve operatori do të vendosë kosha me ngjyra në mënyrë që të kryhet edhe diferencimi i tyre në vendndodhje. Koshat do të jenë me kapakë të mbyllur në mënyrë që të evitohen aromet e pakëndshme. Këto mbetje në fund të çdo dite pune do të depozitohen në vendin e përcaktuar nga NJV.

#### **Sterile të procesit teknologjik**

Për shkak edhe të karakteristikave të përshtatshme që zotëron, sterilet që rezultojnë nga prodhimi i koncentreve mund të përdoret si material ndërtimi.

#### NDIKIMET NGA ZHURMAT

Ushtrimi i këtij aktiviteti do të shoqerohet dhe nga zhurmat e shkaktuara nga makineritë teknologjike si dhe ato të transportit. Zhurmat e ciluara do të jenë brenda normave dhe standarteve të miratuara për këtë qëllim, ndonëse në afërsi të zonën ku do të ndërtohet fabrika nuk ka asnjë zonë të banuar.

#### NDIKIMET E AKTIVITETIT NË RRUGËT LOKALE DHE TRANSPORTIN

Infrastruktura rrugore është shumë e dëmtuar. Aktualisht infrastruktura ekzistuese është e mangët. Ajo do të ndërtohet në funksion të strukturave të propozuara. Infrastruktura ekzistuese rrugore shtrihet deri në parcelën që do të zhvillohet, duke e bërë të aksesueshme dhe duke krijuar lehtësira. Qarkullimi për në parcelë do të bëhet sipas pozicionit që diktojnë vetë godinat, duke ndjekur sistemin e brendshëm rrugor i cili do të pajiset me rrugë të reja. Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do ketë ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirembajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes së mirë të aktivitetit të tij.

#### NDIKIMET E AKTIVITETIT TË ZHVILLIMIT MBI NDËRTIMET, TRASHËGIMINË ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimie arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera. Kjo tregon që zona është zonë e lirë për të realizuar këtë aktivitet.



**NDIKIMI SOCIAL-EKONOMIK**

Me operimin e këtij aktiviteti pritet të ketë një impakt pozitiv në ekonominë e vendit. Operatori do të punësojë personel të zonës, duke bërë të mundur rritjen në nivelin ekonomik dhe të punësimit.

**Analiza S.W.O.T.**

FORCAT	DOBESITE
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Potencial per zhvillimin ekonomik ne rang rajonal</li> <li>➤ Rritje e punesimit ne nivel lokal</li> <li>➤ Ndodhet ne zone periferike nga qyteti.</li> <li>➤ Proces teknologjik bashkekohor dhe paqesor me mjedisin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mungesa e politikave shtetere per perkrahjen e subjektit per zgjerimi dhe ne aspektin e rritjes se punesimit, duke ndikuar ne lobimin e aktiviteteteve te tilla ne shtete te tjera.</li> <li>➤ Evazioni fiskal ne konkurencen e pa ndershme nga kompani te ndryshme.</li> </ul>
MUNDESITE	KERCENIMET
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mundesi perfitimi ekonomike nga prodhimi, shitja dhe eksportimi i produktit.</li> <li>➤ Mundesi punesimi dhe zgjerimi te aktivitetit.</li> <li>➤ Ofrimi i produkteve cilesore, me cmime te konkrueshem ne tregun vendas e te huaj.</li> <li>➤ Maksimizimi i perdorimit te lendes se pare</li> <li>➤ Rikuperim, Riciklim dhe Riperdorim te mbetjeve qe gjenerohen brenda instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Konkurenca e pandershme dhe mos respektimi i detyrimeve dhe percaktimeve ligjore nga subjektet prodhues.</li> <li>➤ Faktore te tille si remonti i instalimit dhe demtimi i cilesise se ajrit.</li> <li>➤ Dukurite natyrore, kryesisht nga termetet</li> </ul>

**6. MASAT ZBUTESE DHE PARANDALUESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS**

<b>REKOMANDIMET</b>	
<b>Toka</b>	
<b>Perdorimi i tokes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara</li> <li>➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve</li> <li>➤ Pastrimi periodik I sheshit te depozitimit te sterileve</li> </ul>
<b>Cilesia e Ajrit</b>	
<b>Emetime</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mbajtja fikur e automjeteve gjate shkarkimit te lendeve te para.</li> <li>➤ Kontroll periodik i pajisjeve qe perdoren per aktivitetin.</li> <li>➤ Perdorimi I mjeteve mbrojtese per frymemarrjen nga ana e punonjesve.</li> </ul>
<b>Mbetjet</b>	
<b>Menaxhimi I mbetjeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit</li> <li>➤ Diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara</li> <li>➤ Transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore.</li> <li>➤ Sterilet te riperdoren per rehabilitimin e rrugeve.</li> </ul>
<b>Zhurmat</b>	
<b>Niveli i zhurmave</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Operimi brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.</li> <li>➤ Respektimi I gjitha rregulloreve gjate procesit te punes.</li> <li>➤ Levizje e ngadalte dhe e kujdesshme ne ambjente te aktivitetit.</li> <li>➤ Vendosja e tabelave zbatimin e rregullores ne ambientet e aktivitetit ne menyre rigoroze.</li> </ul>

## 7. MONITORIMI

**Qëllimi i monitorimit mjedisor** është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

### Monitorimi i mjedisit

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës dhe mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencorë për të përket vrojtimit, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

### Plani i monitorimit në mjedis do të konsistoje në:

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuenca	KUSH?
1.	Monitorim i cilësisë së ajrit	Cdo 6 muaj	L.Akredituar
2.	Monitorim i zhurmave	Cdo 6 muaj	L.Akredituar
3.	Sasia e mbetjeve të gjeneruara	Ne varesi të punës	Operatori
4.	Monitorim i gjendjes teknike të pajisjeve operuese	Cdo 1 vit	Operatori/ teknike të posaçshëm

**“DANMEGER” SHPK**

*Administratori*

**Murat ZGURI**

